

U
R

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare
Nr. 02-48/09-07
Prishtinë, më 30 mars 2007, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Në fillim seancën e kryesoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë, kurse më vonë e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 72 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

RENDITE

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve dhe i transkripteve të seancave plenare të 14, 16 dhe 22 marsit 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Interpelanca e ministrit të Ekonomisë dhe Financave, z. Haki Shatri, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-s,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bletarinë dhe
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me Projektligjin për ditën e dëshmorëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

Deputeti **Ramadan Kelmendi** kërkoi që në seancën e sotme të diskutohet, si çështje e ngutshme, edhe çështja e ndërtimit të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në pjesën veriore të Mitrovicës.

Deputetja **Teutë Hadri** kërkoi që në seancën e sotme të diskutohet, si çështje e ngutshme, edhe për çështjet në shëndetësi.

Deputeti **Lulzim Zeneli** kërkoi që Kuvendi i Kosovës ta nxjerrë një deklaratë përmes së cilës shpreh qëndrimin e tij për propozimin e të dërguarit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, z. Matti Ahtisaari, për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Deputeti **Xhevrat Bislimi** kërkoi që në seancën e sotme të diskutohet, si çështje e ngutshme, edhe ngritjen e çmimeve të energjisë elektrike.

Alush Gashi, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se çështjet e ngritura nga parafolësit e tij duhet të parashtronen në procedurë të rregullt parlamentare.
Ai e mbështeti kërkesën e Qeverisë së Kosovës që Projektligji për Ditën e Dëshmorëve t'i kthehet Qeverisë për ripunim.

Jakup Krasniqi, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se para se të diskutohet për çështjet e ngritura duhet pasur një informatë me shkrim nga Qeveria e Kosovës, kurse për propozimin e ish-presidentit Matti Ahtisaari për zgjidhjen e statusit të Kosovës Kuvendi duhet të mbajë një seancë të veçantë.

Ferid Agani në emër të Grupit Parlamentar për Integrim - tha se për të diskutuar çështjet e ngritura duhet pasur informata me shkrim nga Qeveria e Kosovës.
Për propozimin e ish-presidentit Matti Ahtisaari për zgjidhjen e statusit të Kosovës Kuvendi duhet të mbajë një seancë të veçantë.
Ai i informoi deputetë e Kuvendit se Grupit Parlamentar për Integrim i është bashkangjitur deputetja **Vezira Emrush** në vend të ish-deputetit Rrustem Ibishi.

Pas këtyre diskutimeve kryesuesi, **Xhavit Haliti**, konstatoi: Të gjitha çështjet e ngritura për t'i shqyrtuar në seancën e sotme duhen të parashtronen në mënyrë të rregullt përmes Zyrës për Parashtresa.

Kuvendi miratoi kërkesën e Qeverisë për ta tërhequr Projektligjin për Ditën e Dëshmorëve dhe për ta ripunuar.

2. Miratimi i procesverbaleve dhe i transkripteve të seancave plenare të 14, 16 dhe 22 marsit 2007

Procesverbalet e seancave plenare të 16 dhe 22 marsit u miratuan pa vërejtje.

Deputetja **Gjylnaze Syla** pati vërejtje në transkriptin e 14 marsit, në faqen 13, ku ishte evidencuar: "...do ta kemi mbikëqyrjen ndërkombe të që do t'i mbikëqyrë aranzhimet e brendshme dhe jo vetëm pavarësinë", duhet të hiqen fjalët: "dhe jo vetëm pavarësinë". Në transkriptin e 22 marsit janë përdorur shenjat e pikësimit, që ia kanë ndërruar kuptimin diskutimit.

Deputeti **Xhevati Bislimi** pati vërejtje në transkriptin e seancës plenare të 22 marsit, faqe 63, rreshti i tetë që ishte evidencuar "...një ligj për justifikim", kurse duhet të jetë: "...një ligj për lustrifikimin" dhe në faqen 64, reshti i tetë që ishte evidencuar: "...këto institucione i ruajt gjithmonë policia e Serbisë", kurse duhet të jetë: "... këto institucione i ka ruajtur gjithmonë policia e Serbisë".

Deputetët **Sabri Hamiti** dhe **Besa Gaxheri** dhanë vërejtje të përgjithshme për cilësinë e transkriptimit të seancave plenare, ngase, sipas tyre, bëhen gabime të mëdha gjuhësore, që e ndërrojnë kuptimin e diskutimeve.

Kryesuesi tha se shërbimi i administratës së Kuvendit, që i transkripton seancat plenare, duhet t'i rrit kapacitetet me ekspertë të fushës së gjuhësise, por kjo kërkon rritje të buxhetit të Kuvendit.

3. Koha për pyetje dhe përgjigje

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i parashtroi pyetje ministrit të MASHT lidhur me mospagesën e arsimtarëve në shkollën fillore "Isa Boletini" në Boletin.

Ministri **Agim Veliu** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kelmendi

Deputetja **Selvije Halimi** i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinorë lidhur me hartimin e planit strategjik për ujërat.

Ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjes së deputetes Halimi.

Deputetja **Rudina Bukoshi** i parashtroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit lidhur me hartimin Projektligjit përfuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë dhe për Planin e veprimit të rinisë.

Ministri **Astit Haraqija** iu përgjigj pyetjes së deputetes Bukoshi.

Pas kësaj kohe seancën e ka kryesuar **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit.

Deputeti **Behxhet Brajshori** i parashtroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë Telekomunikacionit lidhur me mënyrën e marruna përritjen e sigurisë në komunikacion në magjistralin Prishtinë-Podujevë, përskaj së cilës kalojnë nxënësit e shumë shkollave fillore.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetit Brajshori.

Deputetja **Rudina Bukoshi** i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me parandalimit të eksploatimit të zhavorrit në lumin Drini i Bardhë.

Ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjes së deputetes Bukoshi.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i kishte parashtruar pyetje zv. kryeministrit **Lutfi Haziri**, por ai nuk ishte i pranishëm. Shtyhet për seancën e radhës.

Deputetët **Ibush Jonuzi** dhe **Zylfije Hundozi** i kishin parashtruar pyetje ministrit **Sadik Idrizi**, por ai nuk ishte i pranishëm në seancë. Shtyhen për seancën e radhës.

4. Interpelanca e ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, z. Haki Shatri, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-s

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e micionit ta merrte fjalën.

Deputeti **Nazim Jashari** në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s – z. ministër kërkesa jonë për interpelancë ka të bëjë me çështjen e menaxhimit të buxhetit të Kosovës. Jeni njeriu më përgjigjës për ta respektuar ligjin për menaxhimin e financave. Siç e dini, Komision Hetimor për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës lidhur me raportin e Auditorit të Përgjithshëm, ka konstatuar që Ministria e Ekonomisë dhe e Financave nuk i ka respektuar dispozitat ligjore duke lejuar pagesën e veturës së blinduar nga via buxhetore për renovimin e objekteve të Kuvendit.

Ministri është përgjegjësi kryesor, që ka mundësuar këtë shkelje të ligjit, që për pasojë ka pasur dëmtimin e buxhetit të Kosovës për 236.000€. Qëllimi ka qenë blerja e një vture dhe është se ajo është pranuar në Kuvendin e Kosovës, mirëpo Komisioni Hetimor ka konstatuar që vutura nuk ka ardhur në Kuvend. Pra, dikush ka përfituar nga një vendim i ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave 236.000€.

Jemi këtu për ta tërhequr vëmendjen tuaj, - që e përbëni shumicën parlamentare, - për shkeljet që janë bërë dhe është në dorën tuaj t'i mermi vendimet, duke i pasur parasysh shkeljet që janë evidente dhe drastike. Unë kërkoj nga ju që të ngriheni në nivelin e përgjegjësive dhe të merni vendimin e duhur, më të mirë të mundshëm, në pajtim me përgjegjësinë politike të çdo zyrtari.

Nuk ka demokraci pa rend dhe pa ligj, prandaj sa herë që të shkelet ligji, duhet të veprojnë mekanizmat që e mbrojnë atë.

Kryetari e ftoi ministrin e Ekonomisë dhe të Financave ta merrte fjalën.

Ministri **Haki Shatri** - Në bazë të kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-s, sot paraqitem në interpelancë për të dhënë sqarim lidhur me zbatimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë përkitazi me “Lejimin joligjor të pagesës së veturës së blinduar nga via tjetër buxhetore”.

Dëshiroj të theksoj që në fillim se Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dëshiron kua të këndoj përmes Departamenti i Thesarit, që kryen procedimin e pagesave të shpenzimeve publike, nuk kanë bërë asnjë shkelje të dispozitave të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dëshiron kua të urdhëresës Administrative mbi procedurat e shpenzimeve me rastin e procedimit të pagesës së veturës për Kuvendin e Kosovës.

Prandaj, as ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave nuk mund t'i mvishet ndonjë lloj përgjegjësie për rastin në fjalë, sepse që pagesat e përditshme që procedohen në Thesar as nuk kanë nevojë ta marrin pëlqimin e ministrit, meqë Departamenti i Thesarit është krejtësisht i pavarur në kryerjen e detyrave të punës, veçanërisht të atyre operative. Konkretisht, pagesa e proceduar nga Thesari nr. 35612 në shumë prej 236.500 euro për Thesarin ka përbushur të gjitha kriteret e përcaktuara me Ligj dhe me Urdhëresën administrative.

Pagesa në fjalë është shoqëruar me urdhër obligimi dhe me dokumentet në vijim, që janë të nevojshme dhe të parapara në këtë dokument. Urdhër- obligimin për pagesë me nënshkrim të zyrtarëve të autorizuar dhe të certifikuar me nr. 64651/2005 të datës 21.11.2005, fletëporosia me të dhënat e furnitorit e dt. 18.10.2005 dhe me nënshkrimin e personave përgjegjës të Kuvendit.

Po ashtu është bashkangjitur Kontrata valide nr. ASS VIP 01/2005 e lidhur ndërmjet porositësit dhe furnitorit. Po ashtu i kemi të bashkangjitur raportin e pranimit të veturës nga zyrtarët e Kuvendit të dt. 25.11.2005 dhe kërkesën e sekretarit të Kuvendit drejtuar Agjencisë të Prokurimit Publik për lejimin e procedurave të negociuara, si dhe kërkesën e miratuar nga Agjencia për procedurat e negociuara.

Nuk ekziston asnjë kërkesë nga ana e Kuvendit të Kosovës drejtuar Ministrisë së Financave për transfer të mjeteve nga një kategori apo kod në tjetrin. Prandaj, nuk ka lejim për transfer të mjeteve nga një kategori në tjetrën.

Pra, nuk ka pasur lejim të ndryshimit të kodit dhe të kategorisë së shpenzimeve nga ana e ministrit as të Thesarit të Ministrisë së Financave.

Pastaj kryetari e hapi debatin lidhur me interpellancën e ministrit Haki Shatri.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së **Gjylnaze Syla**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s **Teuta Sahatqija**, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim Ferid Agani, si dhe deputetët: **Xhevat Bislimi, Bajrush Xhemajli, Selvije Halimi, Nekibe Kelmendi, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti**, që janë pjesë e transkriptit.

Pastaj, ministri Haki Shatri iu përgjigji pyetjeve dhe vërejtjeve të deputetëve.

Në fund, **kryetari** e mbylli debatin lidhur me interpellancën e ministrit Haki Shatri, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-s.

Kryetari dha pauzë për drekë.

Pas pauzës seanca i filloj punimet me shqyrtimin e dytë të projektligjeve.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për Projektligjin për mbrojtjen nga zhurma.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----51;
Kundër----- 1;
Abstenime---- 3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Ligjin për mbrojtjen nga zhurma.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bletarinë

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për Projektligjin për bletarinë.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----67;
Kundër----- 2;
Abstenime---- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Ligjin për bletarinë.

7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me Projektligjin për ditën e dëshmorëve

Me rekomandim të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese dhe me kërkesë të Qeverisë së Kosovës Projektligji për Ditën e Dëshmorëve iu kthye sponsorit – Qeverisë së Kosovës për ripunim.

Kryetari seancën e deklaroi të mbyllur në orën 14:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoï

Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale